

Nxitja e Dialogut Politik për Kohezionin Ndëretnik dhe Social

Raporti i diskutimeve në grup



2025

Nxitja e Dialogut Politik për Kohezionin Ndëretnik dhe Social



**Raporti i diskutimeve
në grup**

Instituti për Politika Sociale “Musine Kokalari” është një institut i pavarur që bashkëpunon me organizata vendore dhe ndërkombëtare për të mbështetur zhvillimin dhe zbatimin e politikave që nxisin përfshirjen, barazinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm. I orientuar drejt së ardhmes, Instituti angazhohet në adresimin e sfidave shoqërore përmes analizës së politikave, ndërtimit të partneriteteve dhe promovimit të vlerave të përbashkëta që kontribuojnë në mirëqenien e përgjithshme.

Mohim përgjegjësie: Ky raport është zhvilluar në kuadër të projektit *“Nxitja e Dialogut Politik mbi Kohezionin Ndëretnik dhe Social”*, financuar nga **National Endowment for Democracy (NED)**. Përgjegjësia për përmbajtjen i takon tërësisht IPS Musine Kokalari dhe UBO Consulting. NED nuk ndan domosdoshmërisht pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura.

E drejta e autorit © 2025 i përket IPS Musine Kokalari dhe UBO Consulting. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet ose transmetohet në asnjë formë ose me çfarëdo mënyre (elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese ose ndryshe) pa pëlqimin paraprak me shkrim të IPS Musine Kokalari dhe UBO Consulting.

Versioni original i këtij raporti është shkruar në gjuhën angleze.



Adresa: Rruga B, Residio (Dervisholli),
Hyrja B, Nr. 15, 10 000 Prishtinë, Kosovë
Kontakti: +383 44 752 353
info@musineinstitute.org
www.musineinstitute.org

Përmbajtja:

Hyrje	07
Metodologjia	08
Rezultatet e diskutimeve	12
Përfundimet	19
Rekomandimet	20

Hyrje

Gjatë periudhës maj-qershor 2025, UBO Consulting, me porosi të Institutit për Politika Sociale “Musine Kokalari”, realizoi tetë (8) diskutime në grup në kuadër të studimit “Nxitja e Dialogut Politik për Kohezionin Ndëretnik dhe Social”. Këto diskutime u zhvilluan me pjesëmarrjen e qytetarëve nga komunitetet joshumicë në Kosovë, me fokus të veçantë te komuniteti serb dhe komunitetet tjera joserbe, si romët, ashkalinjtë, egjiptianët, boshnjakët, goranët dhe turqit.

Nga gjithsej tetë diskutimet e organizuara, pesë (5) janë realizuar me pjesëmarrës të komunitetit serb, përfshirë qytetarë nga komunat e pjesës veriore të Kosovës, si dhe nga komunat e tjera me shumicë serbe, ndërsa tre (3) diskutime janë mbajtur me pjesëmarrës nga komunitetet tjera pakicë joserbe.

Qëllimi dhe objektivat specifike të studimit

Qëllimi i përgjithshëm i studimit ishte të hulumtojë perceptimet dhe përvojat e këtyre qytetarëve në lidhje me marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë, si dhe të identifikojë sfidat dhe pritjet e tyre ndaj politikave publike që ndikojnë në kohezionin social dhe bashkëjetesën.

Diskutimet synuan të ofrojnë një platformë të hapur, gjithëpërfshirëse dhe të sigurt për pjesëmarrësit, duke i inkurajuar ata të ndajnë pikëpamjet dhe përvojat e tyre në mënyrë të drejtpërdrejt, pa hezitim dhe në një atmosferë të rehatshme. Përmes këtij formati, u synua të nxiten reflektime të thella mbi bashkëjetesën ndëretnike, ndjenjën e përkatësisë dhe ndërveprimin me institucionet publike.

Metodologjia

Ky studim është zhvilluar duke përdorur një qasje cilësore metodologjike, përkatësisht përmes organizimit të diskutimeve në grup, të cilat shërbyen si mjete kryesor për mbledhjen e të dhënave. Diskutimet janë dizajnuar për të nxjerrë perspektiva të thelluara mbi marrëdhëniet ndëretnike, përmes përvojave dhe perceptimeve individuale dhe kolektive të pjesëmarrësve nga komunitetet joshumicë në Kosovë.

Në total, janë realizuar tetë (8) diskutime në grup, të strukturuar sipas përkatësisë etnike, gjinisë, grupmoshave dhe vendbanimit të pjesëmarrësve, si më poshtë:

Pesë (5) diskutime janë zhvilluar me pjesëmarrës nga komuniteti serb:

- Tre (3) fokus grupe në komunat veriore të Kosovës (Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan), të ndara sipas grup moshës dhe gjinisë: një grup me burra (mosha 36-65), një me gra (mosha 36-65) dhe një me të rinj (djem dhe vajza, mosha 18-35);
- Dy (2) fokus grupe me qytetarë serbë që jetojnë në pjesë të tjera të Kosovës, përkatësisht një grup me burra dhe një me gra (të dy grupet me përfaqësim të gjerë prej 18 deri 65 vjeç).

Tre (3) diskutime janë zhvilluar me pjesëmarrës nga komunitetet tjera pakicë joserbe:

- Një (1) diskutim në Prizren, me përfaqësues të komuniteteve turk, boshnjak, goran dhe rom;
- Një (1) diskutim në Fushë Kosovë dhe Obiliq, me pjesëmarrës nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian;
- Një (1) diskutim në Gjakovë, i fokusuar në përvojat e komunitetit egjiptian.

Pjesëmarrësit janë përzgjedhur përmes një procesi të kujdesshëm që siguron përfaqësim të balancuar gjinor dhe moshor, si dhe shpërndarje gjeografike të përshtatshme për të reflektuar diversitetin brenda komuniteteve përkatëse. Përmes kësaj strukture, studimi synoi të kapë kompleksitetin e përvojave ndëretnike në rajone të ndryshme të Kosovës.

Ndarja e detajuar e diskutimeve sipas komunës, përkatësisë etnike, moshës dhe gjinisë së pjesëmarrësve është paraqitur në tabelën më poshtë.

Tabela 01


Ndarja e diskutimeve sipas komunave pjesëmarrëse, moshës dhe numrit të diskutimeve

Shpërndarja e diskutimeve		
Komunat përfshirëse	Grupi i synuar	Numri i fokus grupeve
Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan	Burra serbë (mosha 36-65)	1
Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan	Gra serbe (mosha 36-65)	1
Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan	Djem dhe vajza serbë (mosha 18-35)	1
Graçanicë, Ranillug, Shtërpçë	Burra serbë (mosha 18-65)	1
Graçanicë, Ranillug, Shtërpçë	Gra serbe (mosha 18-65)	1
Prizren	Komunitete pakicë joserbe: turq, boshnjakë, goran, rom	1
Fushë Kosovë dhe Obiliq	Komunitete pakicë joserbe: rom, ashkali, egjiptianë	1
Gjakovë	Komuniteti egjiptian	1

Ndërkaq, më poshtë është paraqitur ndarja e sesioneve të diskutimeve sipas numrit total të pjesëmarrësve, kategorizuar në gjini, përkatësi etnike dhe komunë.

Tabela 02


Ndarja e diskutimeve sipas numrit të pjesëmarrësve në bazë të gjinisë, komunës dhe përkatësisë etnike




Graçanica
Gra


Graçanica
Burra

Gjinia			
		Gra	Burra
Komuna	Gra	12	0
	Burra	0	11
	Graçanicë	2	3
	Ranillug	2	2
	Novobërdë	2	2
	Shtërpçë	2	2
	Partesh	2	1
	Klllokot	2	1





Mitrovica
miks


Mitrovica
Gra



Mitrovica
Burra

Gjinia		  		
		Mitrovica miks	Mitrovica Gra	Mitrovica Burra
Gjinia	Gra	8	12	0
	Burra	3	0	11
Komuna	Mitrovicë	4	4	5
	Zveçan	3	4	1
	Zubin Potok	2	2	1
	Leposaviq	2	2	4




Fushë Kosova

Gjinia	Gra	7
	Burra	6
Komuna	Fushë Kosovë	9
	Obiliq	4
Përkatësia etnike	Romë	2
	Ashkalinj	7
	Egjiptianë	4



Prizreni

Gjinia	Gra	9
	Burra	2
Komuna	Prizren	11
Përkatësia etnike	Romë	3
	Ashkalinj	2
	Goranë	1
	Turq	1
	Boshnjakë	4



Gjakova

Gjinia	Gra	7
	Burra	6
Komuna	Gjakovë	13
Përkatësia etnike	Egjiptianë	3

Rezultatet e diskutimeve

Jeta e përditshme dhe shqetësimet e komuniteteve

Tema e parë e trajtuar në kuadër të diskutimeve të mbajtura u fokusua në përditshmërinë e pjesëmarrësve në Kosovë, si dhe problemet kryesore me të cilat ata përballen.

Burrat serbë nga komunat me shumicë serbe si Graçanicë, Shtërpçë, Ranillug, e përshkruajnë jetën si jo edhe aq normale, me pasiguri të vazhdueshme dhe mungesë perspektive për të rinjtë. Ata shprehen se të moshuarit tanimë janë mësuar me këtë realitet, megjithatë mbetet si shqetësim i madh fakti që të rinjtë përballen me mungesë mundësish për të ndërtuar një të ardhme dhe shpesh largohen nga vendi, si pasojë e gjithë kësaj. Përderisa edhe gratë serbe nga kjo pjesë ndajnë po të njëjtat shqetësime, ato njëkohësisht theksojnë ndjeshmërinë emocionale që kanë ndaj vendlindjes dhe lidhjen shpirtërore.

Përtej mungesës së përgjithshme të perspektivës për të rinjtë, burrat theksuan veçanërisht mungesën e mundësive të punësimit dhe ndikimin e politikës dhe nepotizmit në punësim, si problemet kryesore me të cilat ata përballen në këtë aspekt. Tutje, ata e përshkruajnë zhvillimin ekonomik si të stagnuar për shkak të mungesës së bizneseve prodhuese. Ndërkaq, gratë theksojnë mungesën e përputhjes midis arsimit dhe nevojave të tregut lokal të punës, dhe ndonëse vlerësojnë që sektorët si bujqësia kanë potencial, tregjet për produktet mungojnë.

Në mesin e shqetësimeve është gjithashtu edhe sistemi arsimor. Ai përshkruhet me mangësi serioze si mungesa e mësimit praktik, laboratorëve dhe institucioneve të arsimit të lartë. Në këtë aspekt pjesëmarrësit përmendin rënien e numrit të nxënësve dhe mungesën e drejtimeve që përputhen me zhvillimin lokal.

Ndonëse shëndetësia shihet si sektori i cili është funksional dhe i mirë deri diku, pasi që operon përmes sistemit të Republikës së Serbisë, ai thuhet se po përballlet me mungesa të mëdha. Burrat përmendin mungesën

e barnave për shkak të problemeve me banderolat dhe transportin e tyre, ndërsa gratë përshkruajnë mungesën e barnave bazike në barnatoret shtetërore, duke i krahasuar ato me gjendjen e spitaleve të kohës së luftës.

Aspekti i sigurisë paraqitet si njëri ndër shqetësimet e mëdha që kanë banorët e këtyre zonave. Burrat e krahasojnë gjendjen aktuale me vitin 1999 dhe thonë se nuk po shohim asnjë përmirësim. Ata theksojnë që në zona me shumicë shqiptare nuk mund të përdorin lirshëm gjuhën serbe, për shkak të frikës dhe pasigurisë. Gratë ndihen të frikësuara nga reagimet e komunitetit shqiptar dhe po ashtu theksojnë kufizimet në shprehjen publike, megjithëse disa vlerësojnë se të rinjtë kanë më shumë liri krahasuar me të kaluarën.

Edhe pse shumë prej problemeve të lartpërmendura paraqesin shqetësim edhe për banorët e zonave rurale, mungesa e infrastrukturës, shërbimeve bazike, dhe transportit cilësohen si shqetësime shtesë, krahasuar me pjesët urbane. Infrastruktura dhe transporti paraqesin problem veçanërisht kur është fjala për tërheqjen e ndihmave financiare, e cila duhet të bëhet jashtë komunës. Po ashtu, cilësohet që në këto zona ka shumë më shumë migrim, si pasojë e drejtpërdrejtë e mungesës së perspektivës dhe shuarjes së institucioneve serbe që dikur ofronin stabilitet.

Në kuadër të temës së parë, u diskutua gjithashtu edhe për atë se nga kush presin që këto probleme të adresohen. Burrat serbë nga jugu e ndajnë përgjegjësinë për situatën aktuale mes qeverive të Serbisë dhe Kosovës, qeverisjes lokale, bashkësisë ndërkombëtare dhe vetë komunitetit. Marrëveshjet Kosovë-Serbi perceptohen si të dëmshme dhe të pazbatuara, ndërsa qeverisja lokale kritikohet për mungesë angazhimi. Ata shtojnë edhe fajin e komunitetit për pasivitetin dhe mungesën e solidaritetit. Ndërkaq, gratë nga jugu shfaqin zhgënjim të thellë ndaj të gjitha palëve dhe shfaqin ndjeshmëri emocionale ndaj mbylljes së institucioneve dhe mungesës së ndryshimeve reale. Ato theksojnë mungesën e informacionit, zgjatjen e procesit të dialogut dhe mungesën

e besimit në liderët aktual, si faktorë të cilët ndikojnë në huti dhe pasiguri se nga kush të presin zgjidhje të problemeve dhe situatës së përgjithshme.

Rezultatet e diskutimeve nga komunat në pjesën veriore të Kosovës si Zveçan, Zubin Potok, Leposaviq dhe Mitrovicë Veriore, nuk dalluan thellësisht, kur jemi tek kjo temë. Megjithatë, në këto zona, burrat serbë lidhën përkeqësimin e jetesës së përditshme specifiku me mbylljen e institucioneve të Republikës së Serbisë dhe ndalimin e mallrave nga Serbia. Ata ndihen të izoluar dhe e përshkruajnë Policinë e Kosovës si frikësuese. Po ashtu, ata theksojnë se migrimi është tejet më i lartë në këtë pjesë, krahasuar me komunat tjera në Kosovë. Sipas tyre, kthimi i serbëve nga Kosova në Serbi shihet si një formë ruajtjeje e identitetit dhe sigurisë për banorët e komunave të pjesës veriore.

Edhe pse gratë nga kjo pjesë shprehen më të përmbajtura, ato ndajnë shqetësime për mungesën e mundësive për punësim, përkeqësimin e shëndetësisë dhe zhgënjimin në institucionet lokale dhe ndërkombëtare. Ndërkaq, pjesëmarrësit nga grupi me të rinjtë përshkruajnë një realitet të ngarkuar me frikë, mungesë sigurie dhe përfaqësimi. Ata përmendin incidente të drejtpërdrejta, mbylljen e shkollave, mungesën e shërbimeve shëndetësore dhe migrimin e përshpejtuar. Për pjesëmarrësit e këtij grupi, Serbia mbetet aktori i vetëm në të cilin kanë ende besim, edhe pse me rezerva për shkak të mungesës së angazhimit për këta banorë.

Tema e njëjtë u shtjellua gjithashtu edhe në kuadër të tre diskutimeve, të realizuara me anëtarët e komuniteteve pakicë joserbe, përfshirë romët, ashkalinjtë, egjiptianët, boshnjakët, goranët dhe turqit. Këto diskutime u organizuan në komunat Fushë Kosovë, Gjakovë dhe Prizren.

Diskutimi me komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Fushë Kosovë nxori në pah një realitet të karakterizuar nga: pasiguria e lartë ekonomike, papunësia dhe mungesa e qasjes në shërbime të domosdoshme publike. Pjesëmarrësit theksuan se edhe të rinjtë e shkolluar nuk arrijnë të gjejnë punë në sektorin publik apo privat, pavarësisht nivelit të arsimimit. Si rrjedhojë, shumica punojnë në sektorin joformal, shpesh në punë të përkohshme dhe me kushte të vështira. Kjo i detyron disa familje të varen nga ndihmat sociale, të cilat nuk janë gjithmonë të mjaftueshme dhe nuk shpërndahen në mënyrë transparente.

Një nga problemet që u diskutuan me shqetësim ishte mungesa e pediatri në ambulancën lokale, pas largimit të tij për shkak të mungesës së buxhetit. Familjet tani detyrohen të udhëtojnë në Prishtinë për të marrë shërbime shëndetësore për fëmijët e tyre, gjë që shton barrën financiare. Po ashtu, u përmend mungesa e sigurimeve shëndetësore, që ndikon drejtpërdrejt në qasjen ndaj trajtimit mjekësor, sidomos për personat me sëmundje kronike. Transporti publik u evidentua si një pengesë serioze për pjesëmarrjen në arsim dhe treg pune. Mungesa e linjave të rregullta bën që nxënësit nga komunitetet të mos mund të ndjekin mësimet rregullisht. Në këtë pjesë të diskutimit u soll shembulli i një nxënëseje që u suspendua për mungesa të pashmangshme, duke nxjerrë në pah mungesën e ndjeshmërisë institucionale ndaj rrethanave të komuniteteve të margjinalizuara. Probleme të tjera të jetesës së përditshme përfshinin edhe aspektet arsimore, ku përmendet mungesa e stafit arsimor që njeh gjuhën dhe kulturën e komunitetit, si dhe ndjenja se fëmijët nuk inkurajohen të vazhdojnë arsimimin e lartë për shkak të mungesës së perspektivës.

Në këtë komunë, shumë pjesëmarrës e përshkruan ndjenjën e përkatësisë si të fragmentuar, në kontekstin se ku më shumë e shohin vetën të integruar, në Kosovë apo Serbi. Ata e ndjejnë veten të përjashtuar nga rrjedhat shoqërore në Kosovë, të neglizhuar nga institucionet dhe shpesh të identifikuar vetëm në bazë të përkatësisë etnike. Në anën tjetër, ata theksuan që nuk kanë një ndjenjë përfaqësimi as nga ana e shtetit të Serbisë. Diskutimi reflektoi një mungesë të theksuar të përfaqësimit dhe konsultimit në vendimarrje, duke u theksuar se projektet që zhvillohen në lagje shpesh vendosen pa u pyetur komuniteti.

Ndërkohë, Gjakova u përshkrua nga pjesëmarrësit si një realitet edhe më sfidues ekonomikisht për komunitetet pakicë. Komuniteti egjiptian atje jeton në varfëri të thellë, shpesh pa mundësi për të siguruar nevojat elementare. Pjesëmarrësit ndanë raste personale të mos pagesës së qirasë, mungesës së ngrohjes dhe pamundësisë për të siguruar barna për vete apo anëtarët e familjes. Shumica e familjeve janë të papunë, ndërsa ata që punojnë e bëjnë këtë në sektorë të pasigurt dhe shpesh fizikisht të rrezikshëm. Arsimimi i fëmijëve është i ndikuar direkt nga gjendja ekonomike: ka fëmijë që ndërpresin shkollimin për të ndihmuar familjen, dhe mësimdhënësit shpesh nuk tregojnë ndjeshmëri ndaj kushteve të tyre, duke i trajtuar me padrejtësi.

Strehimi u diskutua si një problem që zgjat me dekada. Shumë prej pjesëmarrësve jetojnë në shtëpi pa kontrata të rregullta dhe pavarësisht aplikimeve të vazhdueshme në komunë, nuk kanë marrë përgjigje. Ndihamat sociale shpërndahen sipas njohjeve dhe jo nevojës reale. Edhe në raste emergjente (si probleme shëndetësore akute), pjesëmarrësit raportuan se nuk ka ndihmë nëse nuk njihen personalisht me zyrtarët.

Në Gjakovë, ndjenja e përjashtimit ishte edhe më e theksuar. Pjesëmarrësit treguan se përkundër kontributit të tyre në komunitet, shpesh nuk ndihen të mirëpritur as nga institucionet dhe as nga komunitetet e tjera. Ata përshkruajnë ndjenjën e inferioritetit të përsëritur që nga fëmijëria në shkollë, deri në trajtimin që marrin në institucionet publike.

Në Prizren, pjesëmarrësit raportuan probleme të ngjashme me papunësinë e lartë, sidomos te të rinjtë e komuniteteve rom, boshnjak dhe goran. Shumë prej tyre kishin mbaruar arsimin e lartë, por punësoheshin në sektorë të rastësishëm dhe jo në profesionin e tyre. U theksua mungesa e konkurseve të dedikuara për komunitetet pakicë, gjë që kufizon mundësitë e tyre për të hyrë në institucionet publike.

Gjithashtu, komunitetet ndihen të përjashtuara nga politikat publike, sepse informacioni nuk ofrohet në gjuhën e tyre amtare dhe konsultimi me komunitetet mungon. U raportua mungesa e aktiviteteve kulturore dhe edukative që adresojnë nevojat e komunitetit dhe që ofrojnë hapësira për zhvillim. Strehimi dhe shërbimet sociale gjithashtu u përmendën si sfiduese, megjithëse jo në nivelin e Gjakovës. Komunitetet u shprehën se nuk informohen kur hapen thirrje publike apo kur hartohen plane që ndikojnë direkt në jetën e tyre të përditshme.

Në Prizren, ndonëse pjesëmarrësit theksuan bashkëjetesën ndëretnike si të qetë në pamje të parë, ata ndihen të padukshëm për institucionet dhe të përjashtuar nga mundësitë për zhvillim personal e profesional. Ata përmendën mungesën e aktiviteteve që do të rrisnin ndërveprimin social dhe ndjenjën e bashkëpunimit mes komuniteteve. Të rinjtë veçanërisht ndjehen pa perspektivë dhe të pa përfaqësuar.

Marrëdhëniet ndëretnike dhe shkëmbimi kulturor

Diskutimet vazhduan me temën rreth marrëdhënieve ndëretnike dhe mënyrës se si këto komunitete ndërveprojnë në jetën publike, sociale dhe kulturore. Pjesëmarrësit u pyetën rreth përvojave të përditshme dhe perceptimeve që ata kanë për bashkëjetesën ndëretnike, dhe ndanë mendimet e tyre rreth përjetimeve, pengesave dhe mundësive të mundshme për përmirësim të marrëdhënieve ndëretnike.

Burrat serbë nga komunat në pjesën jugore të Kosovës përshkruajnë bashkëjetesën me komunitetet joshumicë si boshnjakët dhe goranët si të qetë dhe të zakonshme, me bashkëpunim praktik në tregti dhe në ambientet publike. Ndërkaq, marrëdhëniet me shqiptarët përshkruhen si të kufizuara dhe të ndara, të përqendruara vetëm në raporte ekonomike. Në përgjithësi, ata ndihen të kufizuar në shprehjen e identitetit të tyre në hapësirat publike dhe përmendin raste të diskriminimit gjuhësor dhe simbolik, kur është fjala për ndërveprimin apo bashkëjetesën me shqiptarët.

Gratë po ashtu përshkruajnë marrëdhënie korrekte me komunitetet e tjera joshumicë dhe bashkëpunim të rastësishëm me shqiptarët, veçanërisht në kontekste tregtare. Megjithatë, ato theksojnë që gjeneratat e reja janë më të hapura ndaj ndërveprimeve ndëretnike, ndërsa të moshuarit bartin perceptime të formuara nga e kaluara. Në këtë kontekst, ato e shohin edukimin dhe kontaktet personale si mjete për tejkalimin e paragjykimëve.

Ndërkaq, ndërveprimi mes komuniteteve, sidomos atij serb dhe shqiptar në veri të Kosovës, është më i tensionuar. Përderisa burrat nga komunat përkatëse flasin për marrëdhënie të mira me boshnjakët dhe goranët, ata përmendin tensione në rritje me shqiptarët, të ndikuara nga zhvillimet politike. Pavarësisht që ata ndajnë sfida të ngjashme me komunitetin shqiptar, nuk arrijnë të krijojnë lidhje më të thella përmes marrëdhënieve të domosdoshme. Ata e cilësojnë mungesën e sigurisë si pengesë kryesore për shkëmbim kulturor. Ndërkaq, gratë nga po të njëjtat komuna shprehin dëshirë për marrëdhënie të qeta dhe bashkëpunim, por ndihen të zhgënjyera nga pasiviteti i institucioneve. Ato theksojnë ndikimin e politikës dhe edukimit në ndarjet ndëretnike dhe shpresojnë që gjeneratat e reja mund të çojnë përpara përmirësimin e marrëdhënieve.

Këto marrëdhënie përshkruhen si edhe më të tensionuara nga pjesëmarrësit e grupit të moshës 18-35 vjeç. Ata cilësojnë që marrëdhëniet me shqiptarët janë përkeqësuar dhe madje ndihen të rrezikuar nga kjo bashkëjetesë. Ata përmendin raste konkrete të ngacmimeve dhe perceptojnë që ndarjet kulturore dhe arsimore kanë thelluar hendekun. Megjithëse disa përmendin shembuj pozitiv të bashkëjetesës në komunitete të përziera, këto përvoja nuk mjaftojnë për të ndikuar realitetin më të gjerë.

Për dallim nga marrëdhëniet midis komunitetit serb dhe atij shqiptar, komunitetet joserbe në Fushë Kosovë përshkruajnë marrëdhënie ndëretnike përgjithësisht të qeta, por të karakterizuara nga distanca sociale dhe kufizim në ndërveprim. Shkollat dhe ambientet publike nuk ofrojnë mjaftueshëm hapësira për bashkëpunim ndëretnik. Ngacmimet ndaj fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në shkolla përmenden shpesh, duke i bërë familjet të ndihen të pasigurta. U vërejt mungesë aktivitetesh kulturore ndër-komunitare që do të ndihmonin në thyerjen e stereotipave dhe krijimin e një bashkëjetese më përfshirëse.

Edhe në Gjakovë, pjesëmarrësit shprehën se marrëdhëniet ndëretnike janë përgjithësisht të mira dhe bashkëjetesa është e qetë. Megjithatë, theksuan se bashkëpunimi kulturor është i kufizuar dhe nuk ka shumë shkëmbim të vlerave ose traditave mes komuniteteve. U përmend mungesa e hapësirave dhe iniciativave që promovojnë njohjen dhe bashkëpunimin ndërkulturor. Një pjesë e pjesëmarrësve theksoi se do të dëshironin të kishte më shumë aktivitete të përbashkëta që do të ndihmonin në thyerjen e paragjyimeve dhe rritjen e mirëkuptimit reciprok.

Në Prizren, një qytet me përbërje të larmishme etnike, marrëdhëniet ndëretnike janë përshkruar si të mira, por me nivele të ulëta të ndërveprimit të drejtpërdrejt. U përmend se komunitetet bashkëjetojnë në të njëjtën hapësirë por rrallë bashkëpunojnë përtej formaliteteve. Pjesëmarrësit përmendën mungesën e aktiviteteve që synojnë integrimin social, siç janë programet kulturore apo shkëmbimet në shkolla. U theksua rëndësia e rolit të arsimit për të promovuar tolerancën dhe kuptimin ndërmjet komuniteteve.

Qeverisja lokale, përfaqësimi dhe qasja në shërbime

Tutje, në diskutimet e mbajtura u bisedua edhe për pjesën e performancës së qeverisjeve lokale të komunave përkatëse, përfaqësimit të këtyre komuniteteve nga qeverisja aktuale si dhe qasja që qytetarët kanë në shërbimet komunale.

Rezultatet e diskutimit tregojnë që burrat serbë nga komunitat e pjesës jugore të Kosovës ndihen të përjashtuar nga vendimmarrja dhe përfaqësimi në institucionet qendrore të Kosovës. Ata nuk i njohin përfaqësuesit aktual, përveç zyrtarëve nga Ministria për Komunitete dhe Kthim, dhe shprehen se deputetët serbë në Kuvendin e Kosovës nuk kanë ndikim të vërtetë. Ata e konsiderojnë përfaqësimin lokal si më shumë formal sesa real, duke theksuar që vendimmarrja vjen nga niveli qendror. Për këtë arsye, ata e shohin decentralizimin si të pakuptimtë dhe me potencial për të rritur ndasitë administrative. Në anën tjetër, gratë serbe nga këto zona e pranojnë përfaqësimin lokal në gjashtë komunat me shumicë serbe, por ndihen të marginalizuara në nivel qendror për shkak të mungesës së ndikimit të deputetëve. Ato përmendin rolin e faktorëve ndërkombëtarë si më ndikues se përfaqësuesit vendor. Gratë shprehin dëshirën për më shumë autonomi lokale, duke e parë këtë si mundësi për zhvillim ekonomik dhe rritje të punësimit.

Në aspektin e shërbimeve, burrat vlerësojnë disa elemente si furnizimi me ujë dhe energji, por kritikojnë ashpër mirëmbajtjen e rrugëve dhe funksionimin e shërbimeve kadastrale. Ata e krahasojnë Graçanicën si komunë funksionale me komuna të tjera si Parteshi apo Kllokoti që kanë më shumë probleme. Gratë janë përgjithësisht më të kënaqura me shërbimet komunale, duke përmendur përvoja pozitive me dokumente civile dhe qasje në shërbime bazike.

Të dy grupet ndajnë pritshmërinë që komunat të luajnë një rol më të fortë në zgjidhjen e problemeve të përditshme. Burrat shfaqin skepticizëm për autonominë reale të tyre, ndërsa gratë shprejnë që më shumë kompetenca të sjellin përfitime për gratë dhe të rinjtë.

Ndërkohë, në komunat e pjesës veriore të Kosovës, burrat serbë ndihen të përfaqësuar nga të dyja shtetet, si nga institucionet e Republikës së Kosovës, ashtu edhe nga ato të Republikës së Serbisë. Ata përshkruajnë një gjendje pa institucione dhe e quajnë jetën e tyre si të përjashtuar nga sistemi. Ata kërkojnë rikthimin e institucioneve të Republikës së Serbisë si mënyrë për të rikthyer stabilitetin dhe ndihen të detyruar të kryejnë procedura administrative në Serbi. E vetmja përvojë pozitive përmendet me marrjen e letërnjoftimeve të Kosovës, por kjo nuk e ndryshon perceptimin e përgjithshëm. Edhe gratë serbe nga veriu ndihen të pa përfaqësuar dhe e shohin administratën e Republikës së Serbisë në Rudnicë si autoritetin e vetëm aktual legjitim. Ato theksojnë që ndihen mes dy qeverive në Prishtinë dhe Beograd, pa mbështetje të vërtetë. Disa përmendin që përfshirja e figurave neutrale dhe jo-politike në përfaqësim do të ishte më efektive. Ndërkohë, shqetësimet për ndriçimin publik dhe problematikat sociale si ndihma për fëmijët mbeten të pazgjidhura. Në anën tjetër, grupi i të rinjve shfaq edhe më shumë frustrim, duke kërkuar mbylljen e institucioneve të Kosovës dhe rikthimin e atyre të Serbisë. Ata ndihen të pambrojtur nga Policia e Kosovës dhe shprehin një mosbesim total ndaj përfaqësuesve aktual politik të shtetit të Kosovës. Ata kërkojnë krijimin e Asociacionit të Komunave Serbe si mënyrë për të rikthyer një nivel të vetëqeverisjes dhe për t'i adresuar problemet e komunitetit.

Edhe pse nuk ka dyshime në njohjen apo pranimin e institucioneve të Kosovës, komunitetet pakicë joserbe shfaqin përvoja të ngjashme me mungesën e përfaqësimit. Komunitetet në Fushë Kosovë raportuan një ndjenjë të thellë të përjashtimit nga vendimmarrja lokale. Projektet zhvillimore në lagje shpesh realizohen pa konsultim paraprak me banorët. U përmendën raste të ndarjes jo të drejtë të ndihmave sociale dhe mungesës së transparencës në përzgjedhjen e përfituesve. Shërbimet publike nuk janë të qasshme në mënyrë të barabartë - sidomos në fushën e shëndetësisë dhe arsimit. U theksua mungesa e stafit të trajnuar për të komunikuar me komunitetet pakicë dhe pamundësia për të siguruar ndihmë në gjuhët që ata flasin.

Ndërkaq, pjesëmarrësit në Gjakovë përmendën se nuk ndihen të përfaqësuar në mënyrë të barabartë në institucionet lokale. Ata shprehën se shpeshherë nuk konsultohen për çështje që i prekin drejtpërdrejt. Një shqetësim i veçantë u ngrit lidhur me qasjen në shër-

bime publike, veçanërisht në shëndetësi dhe arsim. U përmendën raste kur trajtimi në institucione publike ka qenë diskriminues ose nënçmues. Mungesa e dokumentacionit personal u përmend si pengesë shtesë për përfitimin e ndihmës sociale apo për regjistrimin e fëmijëve në shkollë.

Në Prizren, komuniteti rom dhe egjiptian ngriti shqetësime lidhur me përjashtimin nga përfaqësimi në institucionet lokale. Ata përmendën se nuk ndihen të dëgjuar kur bëhet fjalë për vendime që ndikojnë në jetën e tyre të përditshme. U theksua se përfaqësuesit e komuniteteve në komuna shpesh nuk kanë autoritet të mjaftueshëm për të ndikuar realisht. Po ashtu, u përmend se ndihmat sociale dhe programet për mbështetje shpërndahen në mënyrë selektive dhe jo gjithmonë në bazë të nevojës reale.

Besimi në institucione dhe procesi i dialogut

Përtej perceptimit mbi përfaqësim dhe qasjes në shërbime komunale, pjesëmarrësit në diskutime gjithashtu u pyetën për besimin në institucionet aktuale dhe procesin e dialogut.

Burrat serbë nga komunat e pjesës jugore të Kosovës shprehin mosbesim total ndaj institucioneve të Kosovës. Ata ndihen të përjashtuar nga vendimmarrja, shprehin dyshime për dialogun dhe e konsiderojnë si të zvarritur dhe jo transparent. Ata theksojnë që nuk dinë përmbajtjen e marrëveshjeve dhe shprehin zhgënjim për mungesën e rezultateve konkrete. Ata besojnë se dialogu duhet të përfshijë çështje të ndjeshme si pronat e uzurpuara. Edhe gratë nga kjo pjesë shprehin ndjenja të ngjashme përjashtimi dhe mos informimi. Ato kërkojnë përfaqësues neutral, jo domosdoshmërisht politikan, dhe profesional në dialog, duke e përjashtuar politikën aktuale si jo të besueshme.

Njësoj, burrat nga pjesa veriore e Kosovës shprehin mosbesim ndaj institucioneve të Kosovës, me përjashtim të Avokatit të Popullit që shihet si më i besueshëm. Ata e shohin Policinë si institucionin më të pabesueshëm dhe shprehin të zhgënjyer me BE dhe SHBA për mungesë veprimesh konkrete. Ata përmendin shtete si: Rusia,

Kina dhe Brazili si ndërmjetës më të pranueshëm. Perceptime të ngjashme ndajnë edhe gratë. Ato nuk i njohin përfaqësuesit nga komuniteti i tyre në nivel qendror (deputetët serbë në Kuvendin e Kosovës) dhe e shohin dialogun si jo përfaqësues dhe pa ndikim real. Disa përmendin figura fetare si më të besueshme se politikanët. Ato theksojnë nevojën për rikthimin e institucioneve të Republikës së Serbisë, trajtimin e të arrestuarve dhe qasjen në dokumente.

Ndërkaq, grupi i të rinjve të moshës 18-35 vjeç është edhe më i zëshëm në kundërshtimin ndaj institucioneve të Republikës së Kosovës. Ata kërkojnë mbylljen e tyre dhe shprehin zhgënjim të thellë me gjithë aktorët aktual. Ata përmendin Asociacionin si shpresë të vetme, ndonëse me skepticizëm të thellë për zbatimin e tij.

Pra, për të gjitha grupet e diskutuara, procesi i dialogut perceptohet si i mbyllur dhe jo përfshirës. Ata ndihen të lënë jashtë vendimmarrjes dhe kërkojnë transparencë, përfaqësim të drejtë dhe zgjidhje reale të problemeve të tyre.

Edhe në mesin e komuniteteve pakicë jo serbë, besimi në institucionet e Republikës së Kosovës, gjithashtu, nuk ishte shumë i theksuar. Në Fushë Kosovë, kjo buron nga përvojat e vazhdueshme me trajtim të padrejtë, mospërfillje dhe mungesë reagimi nga ana e autoriteteve lokale. Pjesëmarrësit përmendën raste kur ankesa të paraqitura në komunë kanë mbetur pa përgjigje ose janë injoruar. Mungesa e përfaqësuesve të komunitetit në administratë shton ndjesinë e përjashtimit dhe ul besimin në drejtësi dhe barazi institucionale.

Në Gjakovë, pjesëmarrësit treguan një nivel të moderuar mosbesimi ndaj institucioneve të Republikës së Kosovës, të ndikuar nga përvoja negative me administratën publike. Ndërsa theksojnë që ka individë të përkushtuar brenda institucioneve, shumica ndihen se institucionet nuk funksionojnë në mënyrë të drejtë dhe transparente për komunitetet e tyre. Me këtë rast, u ngrit nevoja për përfaqësues të komuniteteve në pozita vendimmarrëse për të siguruar trajtim më të drejtë dhe përfaqësim më të denjë.

Besimi në institucionet e Republikës së Kosovës në Prizren gjithashtu është i ulët. Kjo lidhet kryesisht me përvojat e padrejta që komunitetet kanë pasur

në të kaluarën, si diskriminimi në shkolla, mungesa e mundësive për punësim në sektorin publik dhe injorimi i kërkesave të komunitetit. Shumë pjesëmarrës u shprehën se për të zgjidhur problemet, ata shpesh i drejtohen organizatave joqeveritare ose individëve me ndikim, pasi nuk presin shumë nga institucionet publike. U kërkuar që institucionet të krijojnë mekanizma për monitorimin e barazisë në trajtim dhe përfshirjen e komuniteteve në konsultime të rregullta.

Qëndrimet ndaj Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe

Pjesa e fundit e diskutimeve u fokusua në vlerësimin e qëndrimeve të pjesëmarrësve lidhur me Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe.

Burrat serbë nga komunat e pjesës jugore të Kosovës e shohin Asociacionin si mekanizmin e vetëm të mbetur që mund të adresojë shqetësimet e tyre kolektive në mënyrë të strukturuar dhe legjitime. Për ta, kjo çështje ka karakter identifikues për komunitetin e tyre brenda Kosovës dhe përfshin çështje thelbësore si: zgjidhjen e fateve të personave të zhdukur, mbrojtjen e pronave të uzurpuara, fuqizimin institucional në arsim dhe shëndetësi, si dhe lehtësimin e integritetit institucionale. Megjithatë, ata shprehen si tejet të shqetësuar për mungesën e transparencës lidhur me përmbajtjen aktuale të marrëveshjeve të arritura mes Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë (ato në Bruksel dhe Ohër) dhe përjashtimin e tyre nga proceset vendimmarrëse. Në anën tjetër, gratë serbe nga komunat përkatëse ndajnë pritshmëri të larta për Asociacionin, të cilin e shohin si mundësi për rikthimin e funksioneve të humbura dhe një garanci për të drejtat komunitare. Edhe pse nuk kanë informacion të plotë për përmbajtjen, ato shpresojnë se Asociacioni do të përfshijë kompetenca të qarta dhe të pavarura, veçanërisht në fushat që prekin drejtpërdrejt jetën e përditshme. Disa kërkojnë përfaqësues neutral, jo politik, për të udhëhequr këtë proces.

Burrat nga komunat e pjesës veriore e konsiderojnë Asociacionin si shpresë të fundit për rikthimin e institucioneve dhe përfaqësimin e serbëve në Kosovë. Ata besojnë se pa këtë strukturë, nuk do të ketë më mekanizma për të adresuar çështjet e komunitetit të tyre. Edhe

pse në të kaluarën kanë qenë skeptikë, aktualisht kërkojnë zbatim të marrëveshjes për Asociacionin me kompetenca të plota. Ndërkaq, gratë nga këto zona theksojnë rëndësinë e Asociacionit për rikthimin e shërbimeve që më parë ofroheshin nga institucionet e Republikës së Serbisë. Ato kërkojnë që kjo strukturë të përfshijë zgjidhje konkrete për problemet e përditshme, si ndihma sociale, dokumentacioni dhe siguria publike. Edhe në këtë grup, ekziston një ndjesi e thellë e përjashtimit dhe pasigurisë për mënyrën si po zhvillohet procesi.

Grupi i të rinjve nga komunat e pjesës veriore të Kosovës, ndonëse më pesimist për mundësinë e zbatimit, e sheh Asociacionin si të vetmen alternativë që mund të rikthejë njëfarë funksionaliteti dhe mbrojtjeje për komunitetin. Ata kërkojnë rikthimin e institucioneve të Republikës së Serbisë dhe shprehen se pa Asociacionin nuk mund të ketë stabilitet.

Në tërësi, për të gjitha grupet serbe të diskutuara, Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe përfaqëson jo vetëm një strukturë institucionale, por edhe një simbol të identitetit, të drejtave dhe sigurisë së komunitetit. Mungesa e informacionit për përmbajtjen konkrete të marrëveshjes dhe përjashtimi nga procesi ushqejnë mosbesimin, por njëkohësisht shpresën e rezervuar për një rikthim të funksionalitetit institucional.

Ndërkaq, duhet cekur që për shkak të mosinformimit të pjesëmarrësve nga komunitetet pakicë joserbe rreth Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, diskutimi në këtë pjesë nuk prodhoi rezultat substancial lidhur me këtë temë.

Përfundimet

Analiza e diskutimeve me përfaqësues të komuniteteve joshumicë në Kosovë paraqet një pamje të ndërlikuar të përditshmërisë së tyre, e ndikuar nga faktorët: ekonomik, social dhe politikë. Megjithatë sfida të tilla si papunësia, qasja e kufizuar në shërbime dhe ndjenja e përjashtimit janë të pranishme në të gjitha zonat e mbuluara nga studimi, mënyra si përjetohen dhe artikulojnë këto probleme ndryshon dukshëm në varësi të kontekstit lokal dhe përkatësisë etnike.

Në jug, komuniteti serb e lidh pasigurinë me mungesën e zhvillimit dhe ndikimin e strukturave vendimmarrëse joefektive. Përfaqësimi politik perceptohet si formal dhe i padobishëm, ndërsa pritjet për përmirësim përqendrohen tek fuqizimi i qeverisjes lokale. Në të njëjtën kohë, për komunitetin serb në veri, problematikat sociale ndërthuren drejtpërdrejt me zhvillimet politike. Mungesa e institucioneve që ata i konsiderojnë legjitime ka përforcuar ndjesinë e izolimit dhe kërkesat për rikthimin e strukturave të mëparshme si garanci për siguri dhe identitet.

Ndërsa për komunitetet joserbe, përjashtimi shfaqet në një formë tjetër: mungesa e pjesëmarrjes në vendimmarrje, pabarazia në shërbime dhe mungesa e konsultimit për çështje që i prekin drejtpërdrejt. Këto komunitete përballen me sfida të qëndrueshme që lidhen më shumë me struktura të dobëta administrative se sa me përkatësinë etnike në kuptimin politik.

Këto përvoja të fragmentuara reflektohen gjithashtu në mënyrën si ndërtohen marrëdhëniet ndëretnike. Në kontekste ku ka më pak tension politik, si në jug apo në Prizren, bashkëjetesa është e qetë, por e kufizuar në nivel praktik. Ndërveprimi social është sporadik dhe zakonisht nuk shkon përtej kontaktit të përditshëm. Në veri, marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve janë më të ngarkuara dhe ndikohen fuqimisht nga mungesa e sigurisë dhe klimës politike.

Kjo shprehje ndërkomunitare shoqërohet nga një mungesë e thellë besimi në institucione, e cila është më e theksuar në mesin e komunitetit serb, sidomos në veri. Institucionet e Republikës së Kosovës nuk perceptohen si përfaqësuese apo të ndershme, ndërsa ndërmjetësit ndërkombëtarë dhe aktorët e jashtëm shihen shpesh si më të besueshëm. Në të gjitha rastet, përjashtimi nga procesi vendimmarrës përforcon ndjenjën e mosbesimit dhe nxit distancim qytetar.

Përfaqësimi politik, si në nivel lokal ashtu edhe qendror, shihet me skepticizëm nga të gjitha komunitetet. Ndërkohë që në jug ka pritshmëri për përmirësim përmes rritjes së autonomisë lokale, në veri kërkohet rikthimi i institucioneve të vjetra ose krijimi i alternativave të reja, si Asociacioni, për ta adresuar boshllëkun ekzistues.

Në këtë kontekst, Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe përfaqëson më shumë se një strukturë institucionale - ai përmendet si një simbol i mbrojtjes kolektive dhe garanci për të drejtat komunitare. Pavarësisht mosinformimit mbi përmbajtjen konkrete të marrëveshjes, pjesëmarrësit e shohin atë si mundësinë e vetme të mbetur për ta rikthyer një ndjenjë funksionaliteti dhe stabiliteti. Megjithatë, përjashtimi nga procesi dhe mungesa e transparencës vazhdojnë të prodhojnë mosbesim edhe ndaj kësaj zgjidhjeje të mundshme.

Rekomandimet

01

Përmirësimi i jetesës së përditshme

- Të nxiten investimet në sektorë që krijojnë vende pune të qëndrueshme në zonat ku jetojnë komunitetet joshumicë, si përmes nismave për mbështetje të ndërmarrjeve të vogla, bujqësisë dhe turizmit rural.
- Të zhvillohen programe trajnimi dhe rikualifikimi profesional, të përshtatura për të rinjtë dhe gratë, që synojnë përfshirjen në tregun lokal të punës.
- Të sigurohet qasje më e lehtë në informacion mbi mundësitë për punësim dhe përkrahje financiare për zhvillimin e bizneseve të vogla.

02

Përmirësimi i marrëdhënieve ndëretnike dhe shkëmbimit kulturor

- Të organizohen më shpesh aktivitete rekreative për komunitetet e ndryshme, si festivale kulturore, ngjarje sportive, ekspozita artistike dhe punëtori edukative, duke nxitur ndërveprimin dhe ndërtimin e besimit ndërmjet banorëve.
- Të krijohen dhe mirëmbahen hapësira të përbashkëta publike (parqe, qendra rinore, palestra komunitare) që mund të shfrytëzohen në mënyrë të barabartë nga të gjitha komunitetet.
- Të rritet ndjesia e sigurisë përmes bashkëpunimit të vazhdueshëm ndërmjet komunave, shërbimeve të sigurisë dhe vetë komuniteteve, me qëllim të krijimit të një ambientit më të qëndrueshëm për të gjithë qytetarët.

03

Përmirësimi i qeverisjes lokale dhe qasjes në shërbime

- Të ofrohen shërbime administrative dhe informuese në gjuhët e komuniteteve që jetojnë në komunat përkatëse, duke respektuar kornizën ligjore për përdorimin zyrtar të gjuhëve.
- Të promovohet përdorimi aktiv i shërbimeve komunale nga ana e qytetarëve të komuniteteve joshumicë përmes fushatave informuese dhe ndërmjetësve lokal.
- Të zhvillohen mekanizma të rregullt për pranimin dhe adresimin e ankesave nga qytetarët, si dhe të rritet përkrahja përmes projekteve që mbështesin infrastrukturën, arsimin dhe shëndetësinë.

04

Rritja e besimit në institucione

- Të rritet cilësia e ofrimit të shërbimeve publike, duke u fokusuar në barazi, profesionalizëm dhe përgjegjshmëri institucionale.
- Të përfshihen qytetarët nga komunitetet joshumicë në procese konsultimi për vendimmarrje që ndikojnë në jetën e tyre të përditshme, përmes forumeve lokale dhe këshillave komunitare.
- Të rriten investimet në infrastrukturë dhe projekte zhvillimore që përmirësojnë drejtpërdrejt jetën e përditshme të komuniteteve, duke ndihmuar në ndërtimin e besimit afatgjatë.

05

Informimi mbi procesin e dialogut dhe rolin e Asociacionit të Komunave më Shumicë Serbe

- Të përdoren mjete të ndryshme komunikimi (takime komunitare, media lokale, rrjete sociale) për të shpërndarë informata të sakta dhe për të luftuar keqinformimin.
- Të promovohet përfshirja e komuniteteve në diskutime rreth temave që lidhen me të ardhmen e tyre institucionale, duke siguruar që informacioni të jetë i kuptueshëm dhe i arritshëm për të gjithë.

